



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

QERSHOR 2021

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Qershor 2021

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2021
Drejtoria e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: Juli.Lubonja@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE _____ **2**

ZHVILLIMET EKONOMIKE _____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit _____ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit _____ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave _____ 5
4. Bilanci i Pagesave _____ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar _____ 7
6. Kredia për Ekonominë _____ 8
7. Oferta e Parasë _____ 9
8. Depozitat sipas burimeve _____ 10

SEKTORI FISKAL _____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar _____ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve _____ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal _____ 13

ANEKSI STATISTIKOR _____ **13**

Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Qershor 2021, arriti në 101.5;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin Qershor 2021 ishte 1.6 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Qershor 2021 ishte 101.93 lekë për dollarë dhe 122.83 lekë për euro;
- Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Qershor 2021 shënuan kuotën 0.49 përqind për ato 12-mujore; 0.29 përqind për depozitat 6-mujore; 0.16 përqind për depozitat 3-mujore dhe 0.40 përqind për depozitat 1-mujore;
- Normat e interesit për huatë në lekë ishin 5.89 përqind për huatë 12-mujore dhe 5.76 përqind për ato 6-mujore;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.501.385 milionë lekë në muajin Qershor, duke shënuar një rritje prej rreth 9.35 përqind, krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e dytë të 2021 rezultoi me rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën -117.27 milionë euro.
- Situata Buxhetore për periudhën Janar - Qershor 2021 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth -29.14 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një deficit prej -49.80 miliardë lekë.
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Qershor 2021, arritën në rreth 234.32 miliardë lekë ose afërsisht 4.2% më shumë se plani për këtë periudhë.
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 263.46 miliardë lekë ose rreth 4% më pak se shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë.

Zhvillimet Ekonomike


1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Qershor 2021 ishte 1.6%, një vit më parë ky ndryshim ishte 1.8%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Qershor 2021, krahasuar me Maj 2021 është -0.9%. Një muaj më parë, Maj 2021, IÇK shënoi rënie mujore prej 0.9%.

Referuar një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Qershor 2020 shënoi rënie mujore prej 0.6%, në krahasim me muajin paraardhës.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- “Ushqime dhe pije joalkolike” me rritje vjetore të çmimit prej +2.7%, duke kontribuar me +0.95 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.6%.
- “Komunikim”, me rritje vjetore +2.8%, duke kontribuar me +0.09 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.6%.



- “Pije alkolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +1.7%, duke kontribuar me +0.06 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.6%.
- “Argëtim dhe kulturë” me rritje vjetore të çmimit prej +1.4%, duke kontribuar me +0.05 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.6%.
- “Hotele, kafene dhe restorante” ka pësuar rritje vjetore të çmimit prej +1.3%, duke kontribuar me +0.05 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.6%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2020	1.5	1.2	2.1	1.9	2.1	1.8	1.4	1.3	1.5	2.0	1.6	1.1
2021	0.4	1.1	1.2	1.9	1.8	1.6	-	-	-	-	-	-

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Qershor 2021, arriti në 122.83 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 0.15 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Qershor, një euro u këmbye me 122.67 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Qershor 2021 arriti në 101.93 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 0.68 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit Qershor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 103.1 lekë/dollarë.



Në krahasim me muajin Qershor të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 1.12 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 7.67 përqind. Në pëgjithësi, dobësimi i lekut në vitin e fundit ka ardhur si pasojë e një rënie relative të ekonomisë në vend, për shkak të dy goditjeve të njëpasnjëshme, tërmetit të ndodhur në dhjetor 2019 dhe situatës së krijuar nga pandemia botërore Covid-19.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatar rreth 0.83 dollarë/euro për muajin Qershor 2021.


Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë kësaj periudhe përmendim: qendrueshmëria e kursit të këmbimit për shkak të ndërhyrjes së shpejtë të BSH-së, stabiliteti i situatës makroekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasiteti në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga BSH-ja, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave


Gjatë muajit Qershor 2021, normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 6 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.49 dhe 0.29 përqind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 1 dhe 3 mujore që arritën kuotën 0.40 dhe 0.16 përqind përkatësisht.

Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12 dhe 6 mujore kanë shënuar rënie mujore prej përkatësisht 0.03 dhe 0.11 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 3 dhe 1 mujore shënuan rritje mujore prej përkatësisht 0.01 dhe 0.02 pikë përqindje.

Referuar një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12 dhe 6 mujore kanë shënuar rritje vjetore përkatësisht prej 0.09 dhe 0.05 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 3 mujore shënuan rënie vjetore me 0.01 pikë përqindje.



Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore, gjatë muajit Qershor 2021, arritën përkatësisht kuotën prej 5.76 dhe 5.89 përqind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 12 mujore kanë shënuar rritje me 0.10 pikë përqindje, ndërsa ato 6 mujore kanë shënuar rënie 0.36 pikë përqindje. Krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rënie vjetore përkatësisht me 0.91 dhe 0.31 pikë përqindje.



Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin Qershor 2021 patën rënie mujore dhe vjetore përkatësisht me 0.18 dhe 0.49 pikë përqindje.



4. Bilanci i Pagesave

Në tremujorin e dytë të vitit 2021, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi negativ në rënie të mjeteve valutore (rezervës) prej rreth -117.2 milionë euro. Për gjysmën e parë të vitit 2021, defiqiti i llogarisë korente u ngushtua në -554 milion euro krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte -613 milion euro. Po ashtu, vetëm për tremujorin e dytë të 2021, llogaria korente e ngushtoi deficitin në -243 milion euro, krahasuar me tremujorin e dytë të 2020 që ishte -378 milion euro.

Në gjysmën e parë të vitit 2021, llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në vlerën +480.3 milion euro krahasuar me +1,407.1 miliard euro në gjashtëmujorin e parë 2020. Ndërsa, vetëm për tremujorin e dytë të 2021, llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në +66.6 mln euro, krahasuar me tremujorin e dytë të 2020.


Në gjysmën e parë të vitit 2021, investimet e huaja direkte shënuan vlerën +480.2 milionë euro ose -2.3%, krahasuar me +491.4 milion euro në gjashtëmujorin e parë 2020. Ndërsa vetëm për tremujorin e dytë të 2021, IHD regjistruan vlerën +243.4 mln euro ose +1.8%, krahasuar me tremujorin e dytë të 2020.

Në gjysmën e parë të vitit 2021, të hyrat nga shërbimet të lidhura përgjithësisht me turizmin u zgjeruan në vlerën +687.2 milionë euro ose +68.2%, krahasuar me +408.5 milion euro në gjashtëmujorin e parë 2020. Në gjysmën e parë të vitit 2021, Remitancat shënuan rritje në vlerën +340.1 milionë euro, krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2020.




5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Qershor 2021, sistemi bankar ka shënuar rënie të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 8.133 milionë lekë krahasuar me muajin Qershor të vitit 2020. Kjo rënie ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies së mjeteve valutore neto të bankës qendrore me 35.930 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 4,843 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 4.394 milionë lekë e Bankave Paradeponituese.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.501.385 milionë lekë në muajin Qershor 2021, duke shënuar një rritje prej rreth 128.427 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 9.35 përqind.

Gjithashtu në muajin Qershor 2021, sistemi bankar rezulton me rritje mujore prej 15,889 milionë lekë ose 1.07 përqind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Qershor 2021 arriti në rreth 624.442 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 34.649 milionë lekë, ose rritje me rreth 5.9 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (53.2%) dhe monedhave të huaja (46.8%).

Gjatë muajit Qershor 2021, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 60.4 përqind ose 376.990 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 35.45 përqind ose rreth 221.336 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 1.9 dhe 2.22 përqind apo 11.894 dhe 13.854 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Qershor 2021, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 72.28 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 24.95 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.19 dhe 0.59 përqind secili.



7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 354.988 milionë lekë në fund të muajit Qershor 2021. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Qershor 2021 ka shënuar rritje mujore prej 0.04 përqind dhe rritje vjetore prej 0.54 përqind, duke arritur nivelin 23.64 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.07 përqind, dhe rritje vjetore prej 0.91 përqind, duke shënuar nivelin 31 përqind.

Fig-11




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 & Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Qershor 2021, kanë shënuar rritje vjetore prej 52.425 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 78.3 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Qershor 2021 shënuan rritje prej 38.269 milionë lekë në krahasim me muajin Qershor 2020. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 81 përqind të tyre.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3


Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Qershor 2021, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 81 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 14.7 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 2.6 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 78.3 përqind dhe rreth 18.8 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 79.5 përqind e totalit.



Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 911,879 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (193.999 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (21.068 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (18.135 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.317 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit Qershor 2021, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.146.398 milionë lekë.




Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 11.508 milionë lekë, gjithashtu krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 90.694 milionë lekë.

Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar - Qershor 2021 janë mbledhur rreth 234.320 miliardë lekë të ardhura, përkundëjt shpenzimeve të përgjithshme prej 263.461 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 216.421 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 46.703 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 51.64% janë financime të brëndshme.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 151.111 miliardë lekë. Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 13.966 miliardë lekë (ose rreth 21.9% më shumë se plani i periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 53.932 miliardë lekë (ose rreth 5.4% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 11.465 miliardë lekë (ose rreth 12.7% më shumë se plani për periudhën Janar-Qershor 2021).



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 216.421 miliardë lekë, 41.391 miliardë lekë (19.12% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 18.325 miliardë lekë (8.5%) për shpenzime interesi, 25.263 miliardë leke (11.7%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 500 miliardë lekë (0.23%) për subvencione, 92.403 miliardë lekë (42.7%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 24.333 miliardë lekë (11.24%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 14.207 miliardë lekë (6.56%) për shpenzimet e tjera. Shpenzimet kapitale u financuan 51.64% me financim të brëndshëm.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Qershor 2021 ishin rreth 234.320 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 219.009 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 11.465 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Janar - Qershor 2021 (mld Lekë) Revenues during January - June 2021 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Qer '21 Jun '21	Qer '20 Jun '20	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	68.41	58.23	+17.5
	Taksa doganore (Custom Tax)	3.32	2.81	+18.3
	Akcizat (Excise)	23.18	19.75	+17.4
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	17.65	13.70	+28.8
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	19.12	15.93	+20.1
	Taksat nacionale (National Tax)	19.43	14.71	+32.1

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: June - 2021

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: June - 2021

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 29.14 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Qershor 2021, u financua kryesisht nga financimi i brëndshëm.

Për periudhën Janar-Qershor 2021, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 234.320 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 263.461 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për periudhën Janar - Qershor 2021, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 219.009 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 216.421 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 92.403 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1 Indeksi i çmimeve të konsumit
Consumer price index (in %)

Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)					Month	
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2016	2017	2018	2019	2020		2021
Janar	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	1.5	2.8	1.7	1.9	1.5	0.4	January
Shkurt	1.1	0.5	0.8	0.6	0.4	1.1	1.0	1.0	1.1	1.1	1.1	1.2	0.2	2.2	2.1	1.7	1.2	1.1	February
Mars	0.5	0.4	0.3	-0.3	0.6	0.7	0.8	0.8	0.9	0.6	0.9	1.0	0.3	2.1	2.0	1.1	2.1	1.2	March
Prill	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2	-0.4	0.2	0.5	0.5	0.5	0.4	0.6	0.8	0.3	1.9	2.1	1.4	1.9	1.9	April
Maj	-1.2	-1.2	-1.2	-1.0	-0.8	-0.9	0.2	0.1	0.2	0.1	0.3	0.5	0.7	2.0	2.1	1.5	2.1	1.8	May
Qershorr	-0.6	-0.4	-0.1	-0.3	-0.6	-0.8	0.04	0.0	0.1	0.1	0.2	0.3	1.2	2.2	2.4	1.3	1.8	1.6	June
Korrik	0.0	-0.1	-0.3	-0.1	-0.5		0.04	0.0	0.1	0.0	0.1		1.9	2.0	2.3	1.5	1.4		July
Gusht	0.9	0.4	0.4	0.3	0.2		0.14	0.1	0.1	0.1	0.1		2.0	1.6	2.2	1.5	1.3		August
Shtator	0.4	0.4	0.2	0.1	0.4		0.17	0.1	0.1	0.1	0.1		1.8	1.6	2.1	1.3	1.5		September
Tetor	-0.2	0.0	-0.2	-0.2	0.2		0.04	-0.1	-0.1	-0.1	0.1		1.8	1.6	2.1	1.3	2.0		October
Nëntor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	-0.5		0.12	0.1	0.1	0.0	0.1		1.9	1.7	1.8	1.4	1.6		November
Dhjetor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	0.3		0.05	-0.1	-0.1	-0.1	0.1		1.9	1.7	1.8	1.4	1.1		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit
Exchange rate

Monedha	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021						Currency
							Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Mesatarja e periudhës													<i>Average of period</i>
USD	125.96	124.15	119.10	107.99	109.85	108.65	101.61	102.22	103.61	102.89	101.24	101.93	USD
EURO	139.74	137.36	134.15	127.59	123.01	123.77	123.53	123.61	123.34	123.10	123.01	122.83	EURO
Fundi i periudhës													<i>In the end of period</i>
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.64	100.84	101.97	101.99	104.91	101.89	100.96	103.10	USD
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	121.77	123.70	123.61	123.67	123.16	123.19	123.05	122.67	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2018	2019	2020	2021						In percent	
				Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June		
Norma e depozitave											
											Deposits rates
12-M	0.73	0.49	0.41	0.47	0.63	0.45	0.47	0.52	0.49		12-M
6-M	0.59	0.42	0.35	0.32	0.29	0.34	0.30	0.40	0.29		6-M
3-M	0.28	0.23	0.21	0.15	0.15	0.16	0.17	0.15	0.16		3-M
1-M	0.76	0.66	0.49	0.41	0.40	0.40	0.42	0.38	0.40		1-M
Norma e huasë											
											Lending rates
12-M	5.66	6.25	6.05	6.85	6.56	5.35	6.34	5.79	5.89		12-M
6-M	8.12	7.07	6.28	5.56	5.39	5.84	5.94	6.12	5.76		6-M
Norma e letrave me vlerë											
											Securities rates
Bono thesari 1/											Treasury bills 1/
3-M	-	-	-	1.09	1.29	1.37	1.37	0.89	0.96		3-M
6-M	-	-	-	-	1.58	1.76	-	1.25	-		6-M
12-M	1.43	1.69	1.77	1.92	2.06	2.13	1.83	1.67	1.49		12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2021

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2021

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M E R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	35,215	69,540	109,350	153,008	191,491	234,320	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	108	331	1,087	2,653	2,711	3,846	Grands
II.	Të ardhura tatimore	33,908	66,871	103,982	142,401	179,308	219,009	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	23,093	46,219	72,778	97,598	123,217	151,111	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	11,205	21,627	31,730	43,046	55,237	68,406	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,553	3,713	10,579	12,994	15,134	17,653	Profit Tax
3	Akcizat	3,185	6,607	10,346	14,049	18,293	23,176	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,382	6,493	9,304	12,905	16,004	19,120	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,394	6,842	9,312	12,533	15,875	19,434	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	375	938	1,506	2,071	2,675	3,322	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,344	2,836	4,920	8,295	10,961	13,966	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	283	572	977	1,988	2,789	3,566	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	2	10	83	255	278	292	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,060	2,254	3,860	6,051	7,894	10,108	Local Taxes
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	9,470	17,816	26,284	36,508	45,130	53,932	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	8,127	15,285	22,587	31,251	38,576	46,155	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,333	2,387	3,457	4,868	5,965	7,075	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	11	144	240	389	589	701	Compensation income in the value of owners
III.	Të ardhura Jotatimore	1,200	2,339	4,281	7,954	9,472	11,465	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë				1,486	1,486	1,486	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	748	1,511	2,740	4,404	5,301	6,627	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	193	323	676	869	1,024	1,270	Utility fees
4	Të tjera	259	505	861	1,191	1,658	2,078	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	33,208	70,042	118,167	167,849	212,160	263,461	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	31,127	63,237	101,632	140,000	175,247	216,421	Current Expenditures
I.1	Personell	6,421	13,212	20,188	27,300	34,188	41,391	Personnel expenditures
1	Paga	5,510	11,326	17,312	23,426	29,312	35,496	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	904	1,855	2,825	3,801	4,778	5,760	Social insurance contributions
3	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	6	31	50	73	97	134	Higher education from its own income
I.2	Interesat	4,547	6,922	9,660	12,320	13,948	18,325	Interest
1	Të Brendshme	3,509	5,304	7,497	9,598	10,657	11,785	Domestic
2	Të Huaja	1,038	1,618	2,163	2,721	3,291	6,540	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	2,366	5,440	10,486	15,505	20,194	25,263	Operational & Maintenance
I.4	Subveclonet	88	177	255	334	415	500	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	13,738	27,152	43,662	59,910	74,991	92,403	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	10,493	20,812	31,480	42,610	53,932	66,772	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,632	5,453	11,000	15,876	19,635	24,092	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	613	887	1,182	1,424	1,424	1,538	Owners' Compensation Fund
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	2,466	6,530	10,762	15,458	19,810	24,333	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,503	3,803	6,619	9,173	11,701	14,207	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	84	175	281	386	482	566	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,219	3,176	5,493	7,628	9,700	11,859	Economic Aid
3	Bonusi i lindjeve	200	400	700	900	1,200	1,400	Birth bonus
I.8	Transferime Kapitale	0	0	0	0	0	0	Capital transfers
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca	92	137	189	240	288	337	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	1,983	5,761	13,391	27,609	36,625	46,703	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm		2,756	7,656	13,373	18,855	24,117	Domestically financing
2	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë		39	64	167	224	349	From higher education system's own revenues
3	Financimi Huaj	1,983	2,966	5,670	7,164	8,377	11,385	Foreign financed
IV	Fondi i rindertimit	6	907	2,955	6,904	9,169	10,851	Reconstruction fund
V.	DEFICITI	2,007	-502	-8,817	-14,841	-20,668	-29,141	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-2,007	502	8,817	14,841	20,668	29,141	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-2,780	1,599	-9,057	1,971	8,488	18,435	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	17	20	25	33	35	104	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	7,460	9,527	17,298	20,331	24,684	31,986	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-10,257	-7,948	-26,379	-18,393	-16,231	-13,655	Others
V.3	I huaj	773	-1,098	17,874	12,870	12,181	10,706	Foreign
1	Hua afatgjatë (e marrë)	1,665	2,560	4,397	6,144	5,439	8,457	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	352	222	366	-745	-13,872	-17,267	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,245	-3,880	-6,279	-11,919	1,224	127	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore			19,390	19,390	19,390	19,390	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source : Ministry of Finance and Economy

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

Tabela e investimeve 2021

Table of investments 2021

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Financim i brendshëm	- 2,779	1,599	- 9,057	1,949	8,488	18,435	Domestic financing
Në %	138.3	321.0	-102.8	13.2	41.1	63.3	In %
Financim i huaj	770	- 1,101	17,871	12,867	12,181	10,706	Foreign financing
Në %	-38.3	-221.0	202.8	86.8	58.9	36.7	In %
Totali	-2,010	498	8,814	14,816	20,668	29,141	Total
Në %	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source: Ministry of Finance and Economy

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2021
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2021**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Taksë doganore	375	938	1,506	2,071	2,675	3,322	Customs Duties
TVSH	7,683	15,813	25,772	35,908	45,787	56,927	V.A.T
Akcizë	3,185	6,607	10,346	14,049	18,293	23,176	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	247	438	625	800	1,055	1,242	Others (Mineral Rent)
TOTALI	11,491	23,797	38,249	52,829	67,809	84,668	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2020 (TAX REVENUE)

TVSH	3,522	5,814	5,958	7,138	9,450	11,479	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,553	3,713	10,579	12,994	15,134	17,653	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,382	6,493	9,304	12,905	16,004	19,120	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	3,146	6,403	8,687	11,732	14,820	18,191	National taxes
TOTALI	11,602	22,423	34,528	44,769	55,407	66,443	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	23,093	46,219	72,778	97,598	123,216	151,111	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source: Ministry of Finance and Economy

Tab - 7

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2021

The Deficit and Its Financing for 2021

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor Jule	
TË ARDHURAT	35,215	69,540	109,350	153,008	191,491	234,320	REVENUE
SHPENZIMET	33,206	70,038	118,164	167,824	212,160	263,461	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	2,010	-498	-8,814	-14,816	-20,668	-29,141	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-2,010	498	8,814	14,816	20,668	29,141	FINANCING
Financimi i brendshëm	-2,779	1,599	-9,057	1,949	8,488	18,435	Domestic
Të ardhura nga privatizimi	17	20	25	33	35	104	Privatization receipts
Hua-marrje e brendshme	7,460	9,527	17,298	20,331	24,684	31,986	Domestic borrowing
Të tjera	-10,257	-7,948	-26,379	-18,415	-16,231	-13,655	Others
Financimi i jashtëm	770	-1,101	17,871	12,867	12,181	10,706	Foreing
a. Hua afatgjatë	1,662	2,557	4,394	6,141	5,439	8,457	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	352	222	366	-745	1,224	-17,267	Chang. of stat. Account
c. Ripagesat	-1,245	-3,880	-6,279	-11,919	-13,872	127	Repayments
d. Mbeshtetje Buxhetore			19,390	19,390	19,390	19,390	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source: Ministry of Finance and Economy

BILANCI I PAGESAVE*Balance of payments**Në milion Euro**In millions Euro*

	2017	2018	2019	2020	Q1_2021	Q2_2021	
Llogaria korente	-865.90	-866.40	-1,088.70	-1,155.90	-309.00	2,460.19	Current Account.
Bilanci tregtar	-2,824.10	-2,871.10	-3,143.80	-2,982.50	-752.00	1,530.54	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	797.10	986.10	906.50	793.60	263.90	337.70	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,621.20	-3,857.20	-4,050.30	-3,776.10	-1,015.90	1,192.84	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	1,081.90	1,111.00	1,263.90	1,056.20	270.30	445.38	Services Balance.
Shërbimet Kredi	2,856.20	3,072.80	3,404.60	2,230.70	582.60	842.61	Services Credit
Shërbimet Debi	1,774.30	1,961.80	2,140.70	1,174.50	312.30	397.23	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	28.60	-13.80	-180.10	-227.00	-75.60	230.72	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	407.40	392.80	420.20	337.10	69.80	71.85	Income Credit
Të ardhurat Debi	-378.80	-406.60	-600.30	-564.10	-145.40	158.87	Income Debt
Bilanci i transfertave	847.70	907.50	971.30	997.40	248.30	253.55	Balance of Transfers
Transferta private	961.80	1,005.40	1,105.50	1,169.70	286.50	293.83	Private Unrequired Transfers
Transfertat shtetërore	-114.10	-97.90	-134.20	-172.30	-38.20	-40.28	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	122.30	104.00	76.10	143.60	98.00	48.76	Capital Account
Llogaria financiare	-1,115.30	-1,142.60	-827.00	-1,507.20	-326.50	-17.79	Financial Account
Investime direkte	-993.80	-1,022.20	-1,036.30	-892.00	-217.80	-225.09	Direct Investment
Investime portofoli	-100.00	-76.10	140.60	-70.30	111.80	78.86	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	49.00	-50.40	50.90	-403.80	-233.80	118.07	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	-186.30	-8.70	107.90	159.60	-41.00	59.41	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	185.40	371.50	-77.70	654.50	74.50	2,586.15	Overall Balance
Rezervat	185.40	371.50	-77.70	654.70	74.50	-117.27	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	70.50	-6.10	-17.80	141.10	-13.30	-10.37	Use of Fund Credit and Loans

*Burimi : Banka e Shqipërisë**Source : Bank of Albania*

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë	2018	2019	2020	2021	2021	2021	2021	2021	2021	2021	Millions of Lek
Fundi i periudhes				Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor		End of Period
				January	February	March	April	May	June		
Mjete valutore neto	724,363	733,114	803,487	799,143	798,942	822,140	815,827	818,341	823,184		Net foreign assets
Pretendime ndaj jorezidentëve	786,907	794,006	860,750	857,054	858,435	883,540	878,195	879,508	886,243		Claims on nonresidents
Minus Detyrime të jorezidentëve	62,544	60,892	57,263	57,910	59,493	61,400	62,368	61,167	63,059		Minus: Liabilities to nonresidents
Mjetet e brendshme	874,968	950,426	1,047,835	1,048,249	1,055,268	1,048,002	1,060,852	1,070,977	1,084,783		Domestic assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	340,781	378,524	435,613	438,525	443,511	433,511	441,793	448,598	456,286		Net claims on central government
Pretendime ndaj sektoreve të tjera	534,187	571,902	612,221	609,725	611,757	614,491	619,059	622,379	628,497		Claims on other sectors
Detyrimet e parasë së gjerë	1,264,127	1,318,662	1,456,993	1,456,814	1,461,513	1,469,247	1,478,476	1,485,496	1,501,614		Broad Money liabilities
Paraja jashtë Korporatave Depozituese	275,285	291,409	344,560	342,887	345,778	347,725	350,545	350,607	354,987		Money outside depository corporations
Depozita të transferueshme	375,047	408,780	490,394	491,196	491,315	498,015	505,270	511,124	520,970		Transferable deposits
Depozita të tjera	613,795	618,473	622,039	622,731	624,420	623,507	622,661	623,766	625,657		Other deposits
Depozita të përfshira në paranë e gjërë	148,927	178,375	186,892	188,628	190,608	191,222	192,235	194,611	198,146		Deposits excluded from Broad Money
Qeveria lokale dhe administrata publike											Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	2,092	3,879	4,666	4,976	5,023	5,213	5,375	5,373	5,572		Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike	376	336	252	249	228	247	277	287	289		Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	7,399	8,238	6,925	7,145	7,213	7,163	7,190	7,832	7,572		Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	139,061	165,922	175,050	176,257	177,956	178,600	179,393	181,119	184,713		Other resident sectors
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	6,183	6,656	5,926	5,087	5,082	5,911	5,909	8,550	5,892		Securities other than shares
Korporata të tjera jofinanciare	164	101	57	56	56	56	56	2,696	57		Korporata të tjera jofinanciare
Sektorë të tjerë rezidentë	6,019	6,555	5,869	5,031	5,026	5,855	5,852	5,854	5,835		Other resident sectors
Huatë	2,838	2,527	3,757	4,411	4,686	4,677	4,975	2,256	3,494		Loans
Qeveria lokale dhe administrata publike											Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	2,838	2,527	3,757	4,411	4,686	4,677	4,975	4,896	3,494		Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike											Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare								-2,640			Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë											other resident sectors
Llogari të pagueshme	285	229	62	59	144	20	57	73	375		Accounts payable
Korporata të tjera Financiare											Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike											Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	1	1	5	5		0	0	1	0		Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	284	229	57	54	144	19	57	72	375		other resident sectors
Aksione dhe instrumenta të tjerë të kapitalit	188,868	200,257	214,394	213,119	212,228	215,953	207,810	208,760	212,608		Shares and other equity
Nga të cilat rezerva rivlerësimi	-6,266	-2,652	-1,095	-1,410	-3,264	-1,718	-4,992	-5,400	-4,455		Of which: Valuation adjustment
Të tjera neto	-12,300	-23,895	-17,621	-21,084	-20,617	-17,512	-13,395	-10,986	-14,672		Other items net
Detyrime të tjera	61,547	50,220	55,892	52,975	51,067	54,175	58,200	60,181	58,735		Other liabilities
Minus: Mjete të tjera	73,847	74,115	73,514	74,059	71,684	71,687	71,595	71,166	73,407		Minus: Other assets
Axhustimi i konsolidimit	403	729	919.0	358.0	567.0	624	613	557	509		Consolidation adjustment

Burlmi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 10 **KREDIA PËR EKONOMINË**
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2018	2019	2020	2021 Janar January	2021 Shkurt February	2021 Mars March	2021 Prill April	2021 Maj May	2021 Qershor June	Million of Lek End of Period
Totali i kredisë	532,818.6	570,792.2	608,779.8	606,283.0	608,065.0	610,800	615,318	618,637	624,786	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale dhe administratën	682.6	560.6	429.1	420.0	410.0	397	387	382	369	Credits to local Government
Në lekë	682.6	560.6	429.1	420.0	410.0	397	387	382	369	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	20,270.0	24,182.4	15,150.8	14,777.0	13,351.0	11,747	12,080	12,768	11,894	Credits to Public Non-financial Corporations
Në lekë	16,594.1	18,489.7	11,819.6	12,165.0	10,450.0	9,532	9,094	10,547	10,181	in Lek
Në valutë	3,675.9	5,692.7	3,331.2	2,612.0	2,901.0	2,215	2,986	2,221	1,713	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera jofinanciare	317,578.4	335,884.5	370,356.3	368,132.0	370,595.0	372,662	375,290	374,768	376,990	Credits to other Non-financial Corporations
Në lekë	127,739.6	141,240.5	161,975.3	162,045.0	163,439.0	164,541	166,321	166,121	165,759	in Lek
Në valutë	189,838.8	194,644.1	208,381.0	206,087.0	207,156.0	208,122	208,969	208,647	211,231	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	10,164.0	13,555.1	13,169.1	13,215.0	13,041.0	13,291	13,296	13,291	13,854	Credits to Other Financial Corporations
Në lekë	4,802.1	8,023.8	7,489.2	7,356.0	7,069.0	7,254	7,465	7,342	7,456	in Lek
Në valutë	5,361.9	5,531.3	5,679.9	5,859.0	5,971.0	6,037	5,831	5,949	6,397	in Foreign Currency
Kredia për sektorë të tjerë rezidentë	184,123.6	196,609.5	209,674.5	209,741.0	210,668.0	212,702	214,264	217,428	221,680	Credits to other resident sectors
Në lekë	118,934.6	130,409.2	138,986.4	139,361.0	140,194.0	142,229	143,485	145,770	148,769	in Lek
Në valutë	65,189.0	66,200.3	70,688.1	70,380.0	70,474.0	70,473	70,779	71,658	72,910	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11

OFERTA E PARASË

Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundit I perludhës	2018	2019	2020	2021						Millions of LEK End of Period
				Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Baza monetare	423,428	433,951	534,347	519,607	523,050	530,271	524,967	521,260	529,287	Monetary base
Paraja jashtë korporatave deponituese	275,285	291,409	344,560	342,887	345,778	347,725	350,545	350,607	354,987	Currency outside depository corporations
Agregati M1	478,721	523,968	637,317	635,405	638,101	644,024	652,101	655,037	663,229	M1 Aggregate
Agregati M2	731,502	758,022	862,338	859,170	861,728	866,989	873,607	875,894	883,837	M2 Aggregate

Burimi : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2018	2019	2020	2021						Millions of Leks End of Period
				Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Totali i depozitave	988,842	1,027,253	1,112,433	1,113,928	1,115,735	1,121,523	1,127,931	1,134,890	1,146,627	Total of deposits
Në lekë	456,217	466,613	517,778	516,283	515,950	519,265	523,062	525,287	528,849	In national currency
Depozitat e transferueshme	169,425	190,538	241,316	239,600	238,803	241,915	246,235	248,333	250,651	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	1,482	1,624	1,644	1,630	1,296	1,656	1,734	1,108	1,268	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	8,662	10,667	13,747	15,053	14,062	13,809	13,247	12,843	12,899	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	2,570	3,694	3,666	3,986	3,505	3,987	3,951	3,579	3,672	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	47,156	49,099	66,074	62,843	59,952	61,090	62,539	66,081	66,401	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	109,555	125,454	156,185	156,087	159,988	161,373	164,763	164,722	166,411	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	34,012	42,021	51,442	52,919	53,519	54,384	55,321	56,096	57,591	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike										Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	199	120	166	126	170	252	208	207	205	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	16	87	131	122	124	133	136	135	77	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,066	2,873	3,970	4,475	4,280	4,218	4,186	4,307	4,903	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	31,730	38,942	47,175	48,196	48,945	49,781	50,791	51,448	52,406	Other resident sectors
Depozita të tjera	252,781	234,053	225,021	223,765	223,628	222,966	221,506	220,857	220,607	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	13	10	10	10	10	10	10			Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,635	709	1,465	900	890	802	769	557	557	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	5,051	4,147	4,868	4,535	4,758	4,350	4,147	4,152	4,445	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	9,687	7,978	6,836	6,502	6,160	6,675	6,160	6,205	6,260	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	236,395	221,210	211,841	211,818	211,809	211,129	210,420	209,943	209,345	Other resident sectors
Në valutë	532,625	560,640	594,655	597,644	599,785	602,258	604,869	609,603	617,777	In foreign currency
Depozitat e transferueshme	205,623	218,241	249,078	251,597	252,511	256,100	259,036	262,791	270,319	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	113	158	82	73	41	42	43	27	25	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,355	2,688	2,246	2,052	2,137	2,081	2,058	3,045	2,395	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	3,616	5,360	6,742	6,535	6,166	5,475	5,415	5,825	5,919	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	75,861	79,001	90,281	91,058	91,206	94,144	96,001	97,217	101,509	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	124,676	131,036	149,726	151,878	152,962	154,359	155,520	156,677	160,471	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	83,610	106,417	120,699	121,584	123,191	122,075	123,189	124,327	125,579	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike										Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	53	136	97	130	201	192	128	160	177	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	0	1	1	0	11	11	10	4	8	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,194	2,786	5,845	5,222	5,694	4,215	4,031	4,204	4,313	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	81,363	103,495	114,755	116,232	117,285	117,657	119,021	119,959	121,081	Other resident sectors
Depozita të tjera	243,393	235,982	224,878	224,464	224,083	224,082	222,644	222,485	221,880	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike				25	25	25	25	25	25	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,696	1,522	1,732	1,846	1,847	2,020	2,010	1,909	1,903	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	3,598	7,058	6,939	6,746	6,770	6,854	6,746	6,742	6,947	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	11,814	11,662	10,854	10,718	10,870	10,660	10,296	10,655	10,612	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	226,284	215,741	205,353	205,128	204,571	204,523	203,568	203,154	202,393	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11 | Tregues të abhënditit financiar (FBI)
(në përqindje)

Financial Soundness Indicators (FSI)
(in percentages)

Klasifikimi i treguesit	Indeksi i treguesit												Indeksi i treguesit			
	Pri 2020	Maj 2020	Qer 2020	Korr 2020	Gsh 2020	Shk 2020	Tet 2020	Nin 2020	Dj 2020	Jan 2021	Shk 2021	Mar 21		Pri 21	Maj 21	Qershor 21
Tregues me bazë kapitalin																Capital-based
Kapitali rregulator ndaj aktiveve të përdorura me rezik (në %)	-	-	18.10	-	-	18.64	-	-	18.32	-	-	18.10	-	-	18	Regulatory capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali rregulator (min lekë)	-	-	151,803.11	-	-	153,807.62	-	-	152,550.65	-	-	155,922.65	-	-	158,486	Regulatory capital (million lek)
Aktive të përdorura me rezik (min lekë)	-	-	838,922.62	-	-	825,308.15	-	-	832,628.31	-	-	861,257.81	-	-	883,172	Risk-weighted assets
Kapitali rregulator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve (në %)	-	-	17.02	-	-	17.48	-	-	17.23	-	-	17.00	-	-	17	Regulatory Tier 1 capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali ndaj totalit të aktiveve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Capital as a percent of total assets
Kapitali rregulator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve	9.31	9.39	9.34	9.12	9.27	9.29	9.27	9.22	9.07	8.91	8.86	9.13	9.16	9.16	9	Regulatory Tier 1 capital as a percent of total assets
Kapitali rregulator ndaj totalit të aktiveve (në %)	9.91	10.00	9.93	9.70	9.89	9.91	9.88	9.82	9.65	9.48	9.41	9.73	9.74	9.73	10	Regulatory capital as a percent of total assets (in %)
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve (në %)	10.21	10.27	10.31	10.27	10.27	10.27	10.36	10.42	10.39	10.34	10.37	10.42	10.11	10.09	10	Shareholders' equity as a percent of total assets (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjoret ndaj kapitalit (në %)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Nonperforming loans net of provisions as a percent of capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjoret ndaj kapitalit rregulator të nivelit I (në %)	12.21	11.61	11.64	11.73	11.67	11.79	11.65	11.92	12.00	11.28	11.55	10.70	10.56	10.50	10	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory Tier1 capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjoret ndaj kapitalit rregulator (në %)	11.46	10.90	10.95	11.03	10.93	11.06	10.93	10.63	11.28	10.81	10.87	10.05	9.92	9.89	9	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjoret ndaj kapitalit aksioner (në %)	11.13	10.61	10.54	10.42	10.53	10.67	10.42	10.02	10.47	9.72	9.87	9.38	9.57	9.54	9	Nonperforming loans net of provisions as a percent of shareholders' equity (in %)
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore) (në %)	5.28	7.78	9.12	9.39	9.92	9.12	9.62	9.91	10.65	11.64	11.58	11.68	11.97	11.57	13	Return on equity (ROE) (annual basis) (in%)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit (në %)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Net open position in foreign exchange as a percent of capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregulator të nivelit I (në %)	7.80	7.32	5.73	6.29	7.09	7.76	7.81	8.76	8.97	7.44	7.70	8.21	4.05	4.87	5	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory Tier 1 capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregulator (në %)	7.14	6.87	5.39	5.91	6.64	7.28	7.33	8.22	8.44	7.00	7.24	7.71	3.81	4.59	5	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner (në %)	6.93	6.69	5.19	5.58	6.40	7.02	6.99	7.75	7.83	6.41	6.57	7.20	3.67	4.43	4	Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %)
Tregues me bazë aktivitet																Asset-based Indicators
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda e gjërë)	34.09	34.23	33.27	33.02	33.35	33.99	34.62	35.46	34.81	34.92	34.25	33.70	32.85	34.09	34	Liquid assets as a percent of total assets (broad measure)
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda bazë)	14.38	13.08	12.04	12.14	12.43	13.13	13.25	14.66	13.56	13.42	12.61	11.98	11.16	12.32	13	Liquid assets as a percent of total assets (core measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda e gjërë)	49.00	46.99	46.10	45.83	46.05	46.68	47.57	47.41	47.39	47.45	46.72	45.87	44.67	46.16	47	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (broad measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda bazë)	20.17	17.96	16.68	16.85	17.17	18.03	18.20	19.60	18.46	18.24	17.20	16.31	15.17	16.69	17	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (core measure)
Kthimi nga aktivitet (ROA) (bazë vjetore) (fitimi neto para taksave)	0.62	0.88	1.03	1.05	1.27	0.97	1.09	1.11	1.20	1.37	1.29	1.25	1.28	1.26	1	Return on assets (ROA) (annual basis) (net profit before taxes)
Huatë me probleme (bruto) ndaj totalit të huave (në %)	8.28	8.14	8.09	8.12	8.13	8.30	8.29	8.20	8.11	8.20	8.15	7.96	7.88	7.80	7	Nonperforming loans (gross) as a percent of total loans (in %)
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve																Income and expense-based
Margjiri i interesit ndaj të ardhurave bruto	65.54	63.36	61.14	60.39	59.88	60.48	59.89	59.31	58.73	52.50	58.37	58.67	58.40	58.53	57	Interest margin to gross income
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Noninterest expenses to gross income
Të tjera																Other
Numri i bankave	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12	Number of banks

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania